

NDËRLIDHJA MIDIS DEHUMANIZMIT DHE DHUNËS NË ÇIFTE

EKSPOZE E TEMËS SË MASTERIT

NGA

MIMOZA XHARRA ROKA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
“ HASAN PRISHTINA “  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË  
PRISHTINË

PRILL, 2021

**Mentori:**

Prof.Asoc.Dr.Kaltrina Kelmendi

**Studentja:**

Mimoza Xharra Roka

## EKSPOZE

Aktualiteti i reformave sociale si dhe rritjes së vetëdijes për aktualizimin e çështjeve të cilët janë të fushës psiko-sociale në shoqëri me pretekst të veçant dhunës në familje dhe në çifte si dhe mënyrat e trajtimit të partnerëve në bashkëjetesë është edhe pikësnyimi i këtij hulumtimi me temë “Ndërlidhja midis dehumanizmit dhe dhunës në çifte”.

Ky hulumtim është bërë në një Qender për mbrojtjen dhe rehabilitimin e grave dhe fëmijëve, në një komun të Kosovës. Pra, duke u referuar në këtë segment, ky hulumtim teoriko-empirike kërkon të gjejë prezencën potenciale të dukurisë psiko-sociale të dhunës në familje më sakt në çifte, më pas prezencës e dehumanizimit në jetën çiftore si dhe ndërlidhjen potenciale mes nivelit të dehumanizimit dhe dhunës në çifte.

Sipas kërkesave metodiko-shkencore dhe natyrës së hulumtimit në fjalë, ky punim fillonë me një abstrakt konçiz për të arriturat e kësaj teze dhe aktualitetit të problematikës, më pas hyrja, si dhe vazhdonë me kapitullin e parë apo pjesën teorike të hulumtimit ku përshkruhen konceptet kryesore të hulumtimit paraprakisht me hulumtimet relevante në këtë fushë. Pjesa e dytë apo kapitulli i dytë rikujton metodologjinë hulumtuese duke filluar me detyrat, qëllimet, variablat, hipotezat, mostara dhe popullacioni si dhe metodat dhe instrumentet shkencore. Pjesa empirike apo kapitulli i tretë në vijim pas metodologjisë ku përshkruhen dhe analizohen rezultatet dhe të dhënat e përpunuara nga dy instrumentet edhe atë me përshkrimin e statistikave deskriptive të variablave dhe të mostrës, tiparet e shpërndarjes së variablës, interpretimi i rezultateve me statistikat konkluzive dhe diskutimi i rezultateve. Kapitulli i fundit, i katërta është përfundimi dhe rekomandimet e sugjerimet të mundshme.

Qëllimi kryesor i hulumtimit është të vërtetohet prezenca si dhe një ndërlidhje potenciale në mes dhunës në çifte dhe nivelit të dehumanizimit në marrëdhëniet martesore apo çiftore.

Ndërsa më poshtë janë të përshkruara hipotezat e këtij hulumtimi:

H1. Shenjat e dehumanizimit dhe pasojat e dhunës janë prezente tek subjektët në atë qendër.

H2. Ekziston një ndërlidhje pozitive mes nivelit të dehumanizimit dhe nivelit të dhunës së ushtruar tek subjektët e qendrës.

H2.1 Ekziston ndërlidhje mes Dehumanizimit dhe nivelit të dhunës

H3. Niveli i dehumanizimit dhe niveli i dhunës determinohet nga karakteristikat demografike dhe sociale të subjektit - viktimë.

H3.1 Ekziston dallim statistikor në nivelin e dehumanizimit dhe nivelit të dhunës te subjektët - viktima varrësisht nga mosha e tyre.

H3.2 Ekziston dallim statistikor në nivelin e dehumanizimit dhe nivelit të dhunës te subjektët - viktima varrësisht nga gjendja civile e tyre.

H3.3 Ekziston dallim statistikor në nivelin e dehumanizimit dhe nivelit të dhunës te subjektët - viktima varrësisht nga nivelin arsimor i tyre.

Pjesëmarrësit në studim janë 56 gra(viktima të dhunës), të cilat kanë kërkuar ndihmë në qendren ne të cilën është bërë hulumtimi, të cilat u janë përgjegjur pyetësorëve online, përmes google form.

Rezultatet

Pra, duke u bazuar tek përmbajtja e H1. Shenjat e dehumanizimit dhe pasojat e dhunës janë prezente tek subjektët në qendrën, e cila pohon prezencën e nivelit sinjifikant të dhunës dhe dehumanizimit në këtë mostër, pra, vetë fakti që sipas koeficientit të korelacionit ekziston ndërlidhje pozitive tregon prezencë të nivelit sinjifikantë të dhunës dhe dehumanizimit në këtë mostër, pra, hipoteza e parë qëndron dhe verifikohet. Si dhe H2. Ekziston një ndërlidhjeje pozitive mes nivelit të dehumanizimit dhe nivelit të dhunës së ushtruar tek subjektët e qendrës, themi se hipoteza e dytë qëndron dhe verifikohet. Poashtu edhe nënhipoteza H2.1 Ekziston ndërlidhje mes

dehumanizimit dhe nivelit të dhunës, sipas analizave të mësipërme nënhipoteza H2.1 qëndron dhe verifikohet.

Ndërsa sipas H3 niveli i dehumanizimit dhe niveli i dhunës determinohet nga karakteristikat demografike dhe sociale të subjektit - viktimë. Sipas përmbajtjes së vetë hipotezës mund të referohemi analizave të regresionit linear për influencën e një grupfaktorëve të një variabël në rastin tonë grupfaktorësh -niveli arsimor, statusi i punës, mosha, gjendja civile dhe numri i fëmijëve ndaj variablës së dhunës dhe trajtimit dehuman. Pra, niveli i dhunës në këtë hulumtim determinohet në masë të vogël nga grupfaktorët niveli arsimor, statusi i punës, mosha, gjendja civile dhe numri i fëmijëve ndaj variablës së dhunës së bashku.

Duke u bazuar te qëllimi kryesor i hulumtimit, i cili u përcaktua si të vërtetohet prezenca si dhe një ndërlidhje potenciale në mes dhunës në çifte dhe nivelit të dehumanizimit në marrëdhëniet martesore apo çiftore në qendër këto tri vitet e fundit duke u anketuar 56 subjekt të gjinisë femrore si viktima të dhunës mbrenda këtyre tri viteve të fundit, të cilët akoma në njëfarë mënyre janë në kontakt me qendrën në fjalë si dhe nga ana tjetër duke u referuar konstatimeve që ekziston ndërlidhje e dobët pozitive në mes nivelit të dhunës dhe dehumanizimit, më tej, niveli arsimor dhe gjendja civile janë dy faktorë të cilët determinojnë në masë më të vogël nivelin e dhunës dhe dehumanizimit në këtë hulumtim, si përfundim mund të themi se qëllimi dhe objektivat e parapërcaktuar sipas standardeve të kërkuara shkencore u arritën dhe u verifikuan.

Për shkak të situatës të pandemisë aktuale si në tërë botën poashtu edhe tek neve si dhe për faktin që vetë natyra e hulumtimit është tepër senzitive nuk u mund të realizohet edhe disa takime me subjektë viktima të dhunës që të sigurohen edhe të dhëna nga përjetimet personale nëpërmjet të protokoleve joformale të intervistës, të cilët të dhëna më pas do të ishin pjesë plotësuese si dhe

konfirmuese të një besueshmërie më të lart të konstatimeve të tanishme nga analizat kuantitative të hulumtimit të përfituara nga anketimi me dy instrumentet me besueshmëri të nivelit të kërkuar shkencor.

Pas këtyre konstatimeve dhe përfundimit në fjalë, duke u referuar aspektit profesional si psikologe si dhe shqyrtimit të literaturës më sipër tek pjesa e parë dhe e dytë të hulumtimit, vijojnë disa rekomandime të cilët dedikohen subjektëve relevantë shoqëror që janë të kyçur në këtë problematikë në mënyrë direkte apo indirekte.